



AMERICAN EUROPEAN SCHOOL

# SHKOLLA E MESME 2022/23 E MJEKËSISË UBT

Top Education for Top Future Generations!

Drejtimit:

- Asistent Dentar
- Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë
- Teknik i Farmacisë
- Teknik i Labororit Mjekësor



JUNIOR HUB **Classroom 3.0**


ISO Certified  
ISO 9001:2015  
ISO 17025:2017

Science  
Technology  
Park

SUSTAINABLE  
DEVELOPMENT GOALS

EFQM  
Leading Excellence



A photograph of two young women with long dark hair, wearing white lab coats, looking towards the left. The image is partially obscured by a dark blue rectangular overlay containing white text.

*Shkolla e parë që implementon  
tërësisht sistemin e edukimit  
bazuar në*

***STEAM, Inovacion  
dhe Ekselencë!***

# RRETH NESH

Fakultetit të Shkencave Mjekësore në UBT, tani i është bashkuar edhe shkollimi i mesëm profesional në fushën e mjekësisë, duke kompletuar zinxhirin e ekosistemit në UBT, një institucioni lider të arsimit në Kosovë e më gjerë.

Shkolla e Mesme e Mjekësisë në UBT është akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, me katër drejtime: Asistent Dentar, Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë, Teknik i Farmacisë dhe Teknik i Laboratorit Mjekësor.

Shkolla e Mesme e Mjekësisë, do të jetë një shkollë model dhe e pakonkurrencë. Shkolla është e vendosur në Parkun Shkencor dhe Inovativ të UBT-së, i cili është i pajisur me laboratorët më të fundit mjekësorë të të gjitha fushave, ku nxënësit vijues të kësaj shkolle do të kenë mundësi që krahas ligjëratave kurrikulare të bëjnë edhe praktikën e përditshme mjekësore- profesionale.

Krahas kësaj, Poliklinika e UBT-së, ka teknologjinë më bashkëkohore për secilën prej këtyre fushave, duke përfshirë ambulancë moderne stomatologjike, laboratorin me aparaturat më të fundit të analizave biokimike, barnatoren, si dhe shërbimin e përditshëm mjekësor.

Kjo infrastrukturë super moderne dhe e kompletuar bashkë me kuadrin më të mirë të mësimdhënësve e me përkujdesjen e jashtëzakonshme të profesionistëve mjekësorë garanton kuadrot më të mira dhe më të përgatiturat profesionalisht për këto fusha në Kosovë.

Shkolla e Mesme e Mjekësisë, krahas mëimit kurrikular ofron edhe kurse të licencuara të gjuhës gjermane dhe gjuhës angleze, si dhe kurse të tjera profesionale, që do të ndihmojnë jashtëzakonisht shumë në formimin profesional të nxënësve.

*Zgjedh më të mirin,  
që të bëhesh më i miri!*

# ASISTENT DENTAR

## Lëndët që mësohen:

### Lëndët e përgjithshme

Gjuhë shqipe dhe letërsi  
Gjuhë angleze  
Gjuhë gjermane  
Matematikë  
Edukatë fizike dhe shëndeti  
Fizikë  
Biologji  
Kimi  
Psikologji

### Modulet Profesionale

Ndërtimi dhe funksioni i trupit të njeriut  
Etika në shëndetësi  
Edukimi shëndetësor dhe parandalimi i infeksionit  
TIK  
Ndërmarrësi  
Pedodonci me Stomatologji preventive  
Parodontologji dhe mjekesi orale  
Sëmundjet e dhëmbit me endodoncion  
Materialet, instrumentet dhe mjetet në klinikën dentare  
Protetikë stomatologjike  
Kirurgji orale dhe Maksillofaciale  
Ortodonci



# PËRSHKRIMI I PROFESIONIT

Asistenti Dentar do të ketë një tërësi kompetencash profesionale të cilat do t'i shërbejnë atij në realizimin më efikas të kompetencave të përgjithshme dhe integrimin e mëtjshëm në shoqëri dhe në tregun e punës gjithnjë në ndryshim. Asistenti Dentar asiston stomatologun në dhënien e shërbimeve stomatologjike të pacientëve. Kandidati që ka kryer shkollimin e mesëm të lartë në profilin Asistent Dentar mund të punësohet nëpër Qendra Klinike, Qendra Spitalore, Qendra për kujdesin e të moshuarve, Klinika private.

Roli i tij është:

- Të përgatis vendin e punës;
- Të marrë të dhënat e pacientit;
- Uljen dhe përgatitjen e pacientit në karrigen stomatologjike;
- Të përgatis instrumentet dhe medikamentet sipas kërkesës së stomatologut;
- Të ndihmoj mbajtjen e kokës së pacientit në intervenime të ndryshme;
- Të mbajë aspiratorin e pështymës në gojën e pacientit;
- Të dezinfektoj dhe sterilizoj instrumentet;
- Të bëjë përgatitjen e salles së operacionit për intervenim kirurgjik;
- Të bëjë përgatitje pre-operative dhe kujdesin post operativ të pacientit
- Të ndihmojë në dhënien e këshillave për higjienën orale.

# BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL I INFERMIERISË

Lëndët që mësohen:

## Lëndët e përgjithshme

Gjuhë shqipe dhe letërsi  
Gjuhë angleze  
Gjuhë gjermane  
Matematikë  
Edukatë fizike dhe shëndeti  
Fizikë  
Biologji  
Kimi  
Psikologji

## Modulet Profesionale

Ndërtimi dhe funksioni i trupit të njeriut  
Etika në shëndetësi  
Edukimi shëndetësor dhe parandalimi i Infeksionit  
TIK  
Ndërmarrësi  
Farmakologji me dozologji  
Mikrobiologji me imunologji  
Biokimi klinike dhe diagnostikë laboratorike  
Kujdesi shëndetësor  
Shëndeti dhe sëmundjet te njeriu I/II  
Kirurgji me përkujdesje  
Kujdesi ndaj të sëmurëve me sëmundje infektive  
Shëndeti dhe sëmundjet te fëmijët  
Gjinekologji me Obstetrikë  
Neuropsikiatri me kujdes



# PËRSHKRIMI I PROFESIONIT

Bashkëpunëtori Profesional i Infermierisë do të jetë i aftë që sipas përkusimit të profesionistit mjekësor të vendos të sëmurin në dhomë dhe në shtrat; të përkujdeset për pozitën dhe higjienën personale të tij (të sëmurit aktiv dhe pasiv); të zbatojë rregullat e mbrojtjes personale dhe të mjedisit.

Bashkëpunëtori Profesional i Infermierisë, për të realizuar kompetencat e përcaktuara duhet të ketë njohuri themelore të Ndërtimit dhe funksionit të organizmit, Parandalimit të infeksionit, Edukimit shëndetësor, Kujdesit Shëndetësor, Shëndetit dhe sëmundjeve të njeriut, Kirurgji me Përkujdesje, Gjinekologji me Obstetrikë, Etikës në shëndetësi, Shëndeti dhe Sëmundjet të fëmijët dhe Neuropsikiatri me Kujdes.

Bashkëpunëtori Profesional i Infermierisë, pas përfundimit të shkollimit do të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte, me shkrim dhe me gojë, për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për argumentuar opinionet për çështje të ndryshme përmes historive infermierore.
- Të përdor burime dhe teknika të ndryshme (përfshirë dhe ato të kompjuterizuara) të mbledhjes dhe shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në zgjidhjen e situatave të ndryshme problemore që do të ndeshë në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të manifestojë qasje të një kritike konstruktive ndaj zhvillimeve profesionale, personale dhe shoqërore.
- Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm për kërkim të vazhdueshëm në drejtim të zgjidhjeve të reja, më efektive.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe globale.
- Të manifestojë guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësisë për të ardhmen e tij.
- Në kontekstin e pavarësisë në vendim-marrje, të tregojë vet-kontroll në ushtrimin e veprimtarive të tij/saj.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve dhe të shfaqë gatishmërinë e vullnetin për një të nxënë që zgjat gjithë jetën.
- Të respektojë parimet e punës në grup multiprofesional dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vet-vlerësojë nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet.

# TEKNIK I FARMACISË

## Lëndët që mësohen:

### Lëndët e përgjithshme

Gjuhë shqipe dhe letërsi  
Gjuhë angleze  
Gjuhë gjermane  
Edukatë fizike  
Matematikë aplikative  
Teknologji e informimit  
dhe komunikimit  
Fizikë  
Kimi  
Biologji  
Ekonomi dhe ndërmarrësi

### Modulet Profesionale

Bazat e anatomisë dhe fiziologjisë  
Organizimi i punës dhe detyrat e teknikut të farmacisë  
në sektorin farmaceutik  
Hyrje në teknologjinë farmaceutike  
Kimi e përgjithshme dhe inorganike  
Botanikë farmaceutike  
Kimi analitike  
Mikrobiologji me imunologji  
Edukatë shëndetësore  
Teknologji farmaceutike  
Farmakologji me dozologji  
Farmakognozi  
Kimi farmaceutike  
Kimi dhe teknologji e ushqimeve  
Kimi organike  
Hyrje në kiminë farmaceutike dhe biofarmaci  
Psikologji  
Kozmetologji  
Etika në shëndetësi





# PËRSHKRIMI I PROFESIONIT

Profesioni Teknik i Farmacisë është një profesion që ka të bëjë me mbarëvajtjen e prodhimit të mirëfilltë të prodhimit të barnave, ku roli i teknikut zë një vend të rëndësishëm para, gjatë, dhe pas procesit të prodhimit duke ndihmuar në aspektin teknik udhëheqësit e sektorëve gjegjëse të prodhimit. Përgatitja profesionale e teknikut të farmacisë në prodhim konsiston në faktin se kjo detyrë është më përgjegjësi dhe mjaft specifike duke pasur parasysh avancimin gjithnjë e më shumë të teknologjisë farmaceutike. Gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave përdor teknologjinë moderne të informacionit dhe komunikimit. Komunikon me përdoruesin (pacientin) e shërbimeve farmaceutike-mjekësore, duke respektuar dinjitetin njerëzor, diversitetin kulturor, fetar, moshën, gjendjen sociale dhe ekonomike.

Tekniku i Farmacisë, pas përfundimit të shkollimit të tre vjeçar duhet të jetë i aftë të ushtrojë këto kompetenca profesionale:

- Përgatit vendin e punës.
- Përzgjedh veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për punë.
- Respekton standardet e profesionit.
- Zbaton rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit dhe etikën mjekësore.
- Lexon dhe interpreton recetën mjekësore;
- Matë, grimcon, tretë, filtron dhe paketon medikamente.
- Përgatit yndyra të ndryshme, tretësira, pluhura dhe forma të tjera galenike në baze të recetës mjekësore, në mënyrë të pavarur;
- Kryen punët administrative laboratorike;
- Dallon preparatet e ndryshme farmaceutike dhe mënyrën e administrimit;
- Aftësohet në manipulimin me pajisjet laboratorike;
- Përzgjedh pajisjet, mjetet e punës dhe materialet e duhura për përgatitjet galenike dhe oficiale;
- Përdor dhe mirëmban pajisjet laboratorike

# TEKNIK I LABORATORIT MJEKËSOR

Lëndët që mësohen:

## Lëndët e përgjithshme

Gjuhë shqipe dhe letërsi  
Gjuhë angleze  
Gjuhë gjermane  
Matematikë  
Edukatë fizike dhe shëndeti  
Fizikë  
Biologji  
Kimi  
Psikologji

## Modulet Profesionale

TIK  
Ndërmarrësi  
Ndërtimi dhe funksioni i trupit të njeriut  
Edukimi shëndetësor dhe Parandalimi i Infeksionit  
Njohurit dhe procedurat e punës në laborator  
Kimi analitike  
Etikë mjekësore  
Procedurat e punës në hematologji dhe transfuzion  
Patologji  
Mikrobiologji me imunologji  
Biokimi klinike dhe diagnostikë laboratorike



# PËRSHKRIMI I PROFESIONIT

Arsimimi në profilin Teknik i Labororit mjekësor, trajtohet në kuadrin e shkollimit të mesëm profesional. Pas përfundimit të shkollimit nxënësi fiton diplomën profesionale me titull Teknik i Labororit mjekësor. Tekniku i Labororit Mjekësor bashkëpunon me profesionistin shëndetësor për dhënien e shërbimeve laboratorike të pacientëve. Kandidati që ka kryer shkollimin e mesëm të lartë në profilin Teknik i Labororit Mjekësor mund të punësohet nëpër Qendra Klinike, Qendra Spitalore, QMF, Qendra për kujdesin e të moshuarve, Klinika private, etj. Roli i tij është:

- Të përgatis vendin e punës
- Përdor drejt materialet, instrumentet dhe mjetet në laboratorin mjekësor
- Bashkëpunon në operimin, kalibrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të përdorura
- Të klasifikon, pastron dhe mirëmban pajisjet laboratorike për kryerjen e analizave specifike
- Të marrë të dhënat e pacientit dhe të përkujdeset për pacientin gjatë dhe pas marrjes së mostrës për analiza të ndryshme;
- Mbledhë, klasifikon, siguron, izolon dhe kultivon mostrat biologjike për analizë laboratorike, si dhe identifikon mikroorganizmat për analizë
- Zbaton procedurat e punës për analiza histologjike, citologjike dhe citogjenetike
- Përgatitë preparatet laboratorike me anë të ngjyrosjes për identifikimin e anomalive/patologjive
- Ndihmon profesionistin mjekësor në inokulimin e vezëve të fertilizuara
- Vendosë mostrat biologjike në aparaturat adekuate dhe monitoron procesin analitik
- Merr mostrën për përcaktimin e grupeve të gjakut, Rh faktorin dhe faktorët e koagulimit
- Vendosë të dhënat nga analizat e testeve laboratorike dhe rezultateve klinike në sistemin e mbajtjes së shënimeve
- Raporton tek profesionisti mjekësor për saktësinë e rezultateve
- Evidenton dhe dorëzon rezultatet
- Punon sipas parimeve etike dhe profesionale
- Ndërmerr masat për parandalimin e infeksionit
- Ofron ndihmën e parë në situata emergjente
- Ndërmerr masat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë

# Lëndët Zgjedhore STEAM

Programi i lëndës zgjedhore është i organizuar në 6 module të cilat zhvillohen nga klasa 10-të deri në klasën e 12-të, si mëposhtë:

## Klasa 10

Augmented and Virtual Reality  
Programing and Cyber Security



## Klasa 11

Application Development  
Networking and Information Systems



## Klasa 12

Artificial Intelligence  
Internet of Things and Big Data



# *Top Education for Top Future Generations!*





# STAFI

35%

Femra

212

Personel  
Administrativ  
dhe Teknik

588

Akademik

318

Akademik  
me Doktoraturë



SHKOLLA  
E MJEKËSIS

# INFRASTRUKTURA

40 E-Learning



Classroom 3.0



7 Librari me mbi  
250,000 libra



120  
Laboratore



Barnatore



Poliklinikë



E MESME  
KËSISË



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Ministria e Arsimit,  
Shkencës dhe Teknologjisë

E licensuar nga MASHT-i



**EFQM** Recognized for  
Leading Excellence Excellence 5 Star

UBT lider në implementimin e standardeve ndërkombëtare dhe evropiane për cilësi,  
vlerësuar nga The European Foundation for Quality Management (EFQM) me  
Çmimin e Ekselencës me Pesë Yje.

ISO Certified

ISO 9001:2015

ISO 17025:2017



SHKOLLA  
E MJEK




# AMERICAN EUROPEAN SCHOOL

bazuar në përvojat më të mira  
në botë



E MESME  
KËSISË



# MISIONI

Misioni i Shkollës së Mesme të Mjekësisë është të sigurojë një program cilësor dhe të përshtatshëm, një mjedis mësimor frymëzues e atraktiv, që do të përmbushë nevojat e nxënësve për arritjen e qëllimeve të tyre të larta arsimore, me standardet më të vlerësuara.

# VIZIONI

Shkolla e Mesme e Mjekësisë në UBT do të jetë model i shkollimit për kuadrin mjekësor, duke vendosur një standard të lartë profesional në mësimdhënie teorike dhe në punë praktike. Synimi ynë është përsosshmëria të cilin do ta arrijmë me stafin e avancuar të mësimdhënësve, metodologjitë e reja mësimore dhe infrastrukturën më moderne shkollore në rajon.

# VLERAT



EKSELENCË



TEKNOLOGJI



UDHËHEQJE



ZHVILLIM TË TALENTIT



QËNDRUESHMËRI



INOVACION

# CILAT DOKUMENTE MË DUHEN PËR REGJISTRIM?

- Formulari për regjistrim  
(mund ta shkarkoni në [shm.ubt-uni.net](http://shm.ubt-uni.net))
- Certifikata e lindjes
- Kopja e letërnjoftimit të prindit/kujdestarit ligjor
- Dëftesa për kryerjen e shkollës së mesme të ulët
- Dëftesa e testit të semi-maturës

## PËR PRINDËRIT

Dërgimi i fëmijës suaj në Shkollën e Mesme të Mjekësisë, është një mënyrë e shkëlqyeshme që ata të zhyten plotësisht në kulturën perëndimore të shkollimit. Standardi i lartë i mësimdhënies me staf të kualifikuar e të avancuar, e bën unik e të pa konkurrencë Shkollën e Mesme të Mjekësisë më të re në vend.

Nxënësit e kanë mundësinë që të zhvillojnë dhe mbajnë praktikën në laboratorët, poliklinikën dhe barnatorën e UBT-së duke shfrytëzuar ambientet dhe strukturën moderne e inovative në Parkun Shkencor Inovativ të UBT-së.



# CILAT JANË KRITERET PËR PRANIM?

Të gjithë të interesuarit për regjistrim në Shkollën e Mesme të Mjekësisë duhet të kenë të përfunduar shkollimin në nivelin e mesëm të ulët dhe të kenë dëshmi (dëftesën) të përfundimit të suksesshëm të testit të semi-maturës.



# JUNIOR HUB

Jo vetëm shkollë  
por një ekosistem për të rinj!

Krahas mësimet kurrikular të kombinuar me Classroom 3.0, ne ofrojmë kurse dhe aktivitete të llojllojshme edukative e argëtuese përtej asaj kurrikulare për formimin sa më të mirë të gjeneratës së ardhshme, duke përfshirë por jo kufizuar në kurset si:



GJUHË ANGLEZE



FUTBOLL



PROGRAMIM



MATEMATIKË



BASKETBOLL



AVR



ORIENTIM NË  
KARRIERË



KLUBI I  
LEXIMIT



ROBOTIKË



TË MENDUARIT  
KRITIK



NOT



KIMI



# APLIKO TANI!

SHKOLLA E MESME E MJEKËSISË

Website:

[shm.ubt-uni.net](http://shm.ubt-uni.net)

Email:

[shm@ubt-uni.net](mailto:shm@ubt-uni.net)

Tel:

+383 46 33 22 33

Lokacioni:

Parku Shkencor Inovativ UBT Qyteti i Mençur, Lipjan